



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:132226

Datë: 06.12.2024

Numri i dokumentit: 06563051

C.nr.391/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Berkan Hamza dhe me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses E.B nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I.Xh-K, avokate në Suharekë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 391.24 euro, jashtë seance me datë 06.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses E.B.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses E.B nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore 01 Maj – 31 Dhjetor 2021, në shumën prej 68.75 euro, si dhe për periudhën kohore 01 Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 313.72 euro, apo në shumën e përgjithshme prej 382.47 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 07.05.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses E.B, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: mbi shumën e gjykuar prej 382.47 euro, deri në shumën prej 391.24 euro, dhe atë në shumën prej 8.77 euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses E.B, ti paguaj shumën prej 99.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit, refuzohet pjesa tjetër e shpenzimeve procedurale përtej shumës prej 99.00 euro, deri në shumën prej 125.00 euro, dhe atë në shumën prej 26.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësja E.B, në këtë gjykatë me datë 07.05.2024, përmes të autorizuarës të saj I.Xh-K, avokate në Suharekë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të nenit 35 paragrafi 10 i Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe

22.01.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. Ka kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që paditëses në emër të kompensimit të shtesë mbi bazën e përqindjes të inflacionit të ia paguaj shumën prej 391.24 euro, për periudhën nga data 09.05.2021 e deri me datën 21.11.2022, bazuar në pagën bazë prej 252.76 euro, dhe atë: Për vitin 2022 norma e inflacionit ka qenë 11.6%, në euro 29.32 në muaj X 11 muaj = 322.52 euro, si dhe për vitin 2021 norma vjetore e inflacionit ka qenë 3.4%, 8.59 euro në muaj x 8 muaj = 68.72 euro, të gjitha me kamat ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 18.09.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Paditësja ka ushtruar padi në gjykatë më 07.05.2024, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e përqindjes së inflacionit, për periudhën kohore nga 09.05.2021 – 21.11.2022, në mbështetje të Kontratës Kolektive, me kërkesëpadi ka kërkuar kompensim përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive. I njëjti ka theksuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, kërkesëpadija e paditëses është parashkruar. Duke shtuar se padia e paditëses nuk është e bazuar në asnjë bazë të vlefshme juridike, rrjellimisht nga provat e paraqitura dhe pretendimet e parashtruara me padi, paditësja nuk ka arritur ta argumentoj themelësinë e kërkesëpadiës ndaj të paditurës. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Lidhja e Prizrenit” në Rahovec. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëses është shuma prej 253.60 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka

hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses E.B, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për periudhën Maj – 31 Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 253.60 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 68.75 euro ($253.60 * 3.4\% = 8.59 * 8 = 68.75$).

Për periudhën Janar 2022 - 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 253.60 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 313.72 euro [$253.60 * 11.6\% = 29.32 * 10 = 293.20$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 20.52 euro ($29.32/30 = 0.97 * 21 \text{ ditë} = 20.52$) = $293.20 + 20.52 = 313.72$).

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtuftjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë*

në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditëses është dorëzuar më datën 07.05.2024, ndërsa kërkesëpadia e paditëses përfshin periudhën kohore prej datës 01.05.2021 deri me datën 31.12.2022. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Gjykata e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë të paditëses për periudhën kohore 22 Nëntor – 31 Nëntor 2022, pasi që sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 09.10.2023, realizimi i të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021, duhet të trajtohen deri më datën 21.11.2022, kur edhe është shkëputur kjo kontratë nga njëra kontaktuese. Andaj, kërkesëpadia e paditësit që përfshin periudhën kohore prej datës 22.11.2022 deri më datë 31.12.2022, në shumën prej 8.77 euro është refuzuar për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padisë në këtë gjykatë (date e parashkrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësja vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që e paditura, t’ia kompensojë paditëses shumën si në pikën IV. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

Sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë në kontestin e vlerës së vogël është paraparë kompensimi në shumën prej 78.00 euro. Pasi që kërkesëpadia e paditësit është në lartësi prej 391.24 euro, që përbën kontest të vlerës së vogël, andaj pjesën tjetër të shpenzimeve procedurale përtej shumës prej 99.00 euro, deri në shumën prej 125.00 euro, dhe atë në shumën prej 26.00 euro, gjykata e ka refuzuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.391/2024, më datën 06.12.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.